

FJALA E DEPUTETES ETILDA GJONAJ

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

E para, duhet të kuptojmë që ky buxhet vjen në një moment vërtet sfidues gjeopolitik, për shkak të luftës të paprecedentë të Rusisë kundër Ukrainës dhe, si çdo vend i Europës, Shqipëria po përballet në mënyrë horizontale me inflacionin dhe krizën energjetike si pasojë e kësaj lufte.

Pavarësisht kësaj, bazuar në raportin e Bankës Botërore të muajit tetor, Shqipëria ka pasur inflacionin më të ulët, krahasuar me të gjitha vendet e rajonit, ku Bosnjë-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut e kanë 21% vlerën e inflacionit. Në këtë raport thuhet shprehimisht se tashmë inflacioni pritet të qëndrojë në të njëjtat vlera të rritura në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, me përjashtim të Shqipërisë.

Ky nuk është një buxhet i zakonshëm në një kohë të zakonshme, pasi në dimension global ndikimi i pasojave të luftës është më se i ndjeshëm edhe për vendin tonë. Detyra që qeveria ka dhe e ka bërë më së miri e në mënyrë konkrete edhe me buxhetin e vitit 2023, është përballimi i pasojave të kësaj lufte për shtresat më në nevojë të shoqërisë. Kjo është një politikë që po ndiqet nga të gjitha shtetet, pavarësisht mundësive dhe nevojave në sektorë të ndryshëm. Jemi të vetëdijshëm që do të duhej të kishte më shumë buxhet në disa sektorë edhe për projekte të reja, por prioritet është mbrojtja e qytetarëve nga kriza energjetike dhe inflacioni në rritjen e çmimeve.

Vendimi i dy ditëve më parë i qeverisë shqiptare për të mos rritur çmimin e energjisë mbi fashën 800 kilovatë edhe për muajin nëntor është një faturë që qeveria e ka marrë përsipër dhe e ka hequr nga barra e shpenzimeve të qytetarëve dhe bizneseve për të mos i rënduar në këto kohë krize, në krahasim me disa vende të tjera ku qytetarët janë përballur me rritje shumëfish të çmimit të energjisë.

Objektivi parësor i këtij buxheti është përballimi i pasojave të luftës, duke u ardhur në ndihmë të qytetarëve me rritjen e pagave, me rritjen e ndihmës ekonomike, paketën e re të rezistencës, rritjen e garancisë sovrane, rritjen e pagës minimale, ndihmën e posaçme për grupet në nevojë dhe shumë

ndihma të tjera, të cilat përkthehen në ndihmë ekonomike dhe financiare të drejtpërdrejtë në xhepat e shqiptarëve në këto kohë krize.

Pavarësisht kësaj, prioritetet e qeverisë në reformat për forcimin e shtetit dhe reformat për të arritur rekomandimet për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, vijojnë të jenë të financuara sipas nevojave në buxhetin e vitit 2023.

Reforma në drejtësi, reformat për mirëqeverisjen, reforma në përfshirjen sociale, rimëkëmbjen ekonomike dhe mbështetjen për energjinë, si programe prioritare të integritit në Bashkimin Europian, vijojnë të jenë prioritare edhe për buxhetin e vitit 2023.

Reforma në drejtësi, si një ndër prioritetet kryesore të qeverisë edhe për integrimin europian, ka të akomoduar në buxhetin e vitit 2023 zbatimin e rekomandimeve të progres-raportit të këtij viti, duke rritur buxhetet e institucioneve të pavarura, për të arritur rezultate jo vetëm në rritjen e eficiencës së drejtësisë, por edhe në luftën kundër korrupsionit, në total me 5% më shumë sesa vitin e kaluar, me rritje domethënëse kryesisht në institucionet e vetingut, për të përfunduar sa më shpejt procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ashtu edhe për prokurorinë e posaçme deri në masën 12%. Gjithashtu, është planifikuar edhe vazhdimi i projektit të BE-së për drejtësinë për vitin 2023, në vlerën 11 milion euro.

Ajo që konsiderohet reforma për mirëqeverisjen dhe që përfaqëson disa kapituj, për të cilat Shqipëria po kryen procesin e vlerësimit të legjislacionit me Bashkimin Europian, një proces shumë sfidues dhe shumë i imtësishëm, është, gjithashtu, një program prioritar i mbështetur nga buxheti i vitit 2023.

Si për masat për luftën ndaj korrupsionit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, për eficiencën e një administrate profesionale, me integritet dhe të qëndrueshme, reformën në financat publike, decentralizimin, si dhe për shërbimet digjitale dhe mbrojtjen e tyre, për të bërë të mundur konsolidimin e masave për ofrimin e shërbimeve me cilësi dhe kohë të shpejtë, infrastrukturën digjitale, si dhe sigurinë kibernetike, buxheti i vitit 2023 parashikohet të jetë rreth 3 miliardë lekë më shumë sesa buxheti i rishikuar i vitit 2022.

Gjithashtu, do të vijojë mbështetja buxhetore nga Bashkimi Europian përmes programit EU good governance IPA 2020 pikërisht për këtë reformë për sa i përket mirëqeverisjes me një fond total deri në vitin 2024 prej 48,1 milionë euro.

Programet për rimëkëmbjen ekonomike janë të buxhetuara në buxhetin e vitit 2023, për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve dhe kritereve të progres-raportit për një ekonomi konkurruese, si brenda vendit, ashtu edhe në tregun ndërkombëtar, reduktimin e informalitetit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, avancimin në fushën e inovacionit të bizneseve, start-up-ve dhe sektorit të turizmit.

Ashtu si edhe në këtë sektor dhe në reformat e tjera, mbështetja e Bashkimit Europian është një vlerë e shtuar e asaj që planifikohet në buxhetin e vitit 2023, e cila do të jetë 2,85 milionë euro.

Mbështetja për energjinë, si një objektiv tashmë edhe i Bashkimit Europian, për efekt të krizës energjetike, do të jetë edhe nga BE-ja nëpërmjet alokimit të një fondi prej 85 milionë eurosh të llogaritura deri tani, nga të cilat 68 milion euro pritet të disbursohen brenda vitit 2023.

Objektivat që janë të mbështetura nga buxheti i shtetit për energjinë lidhen, ndër të tjera, edhe me rritjen e përdorimit të energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2022 dhe rritjen e eficiencës së energjisë me 6,5% krahasuar me një vit më parë.

Gjithashtu, si një prioritet shumë i rëndësishëm i grup-kapitujve të negociatave me Bashkimin Europian, bujqësia mbetet prioritet që mbështetet nga buxheti i shtetit, duke konsideruar një pjesë të rekomandimeve dhe kritereve të përcaktuara për kapitullin përkatës, me qëllim rritjen e performancës së sektorit të bujqësisë si dhe përmirësimit të konkurrueshmërisë. Vlerë e shtuar këtu janë fondet dhe programi IPARD II, i cili do të vijojë mbështetjen edhe për vitin 2023 për rreth 260 përfitues.

Heqja e TVSH-së për programet e IPA-s dhe fondeve të tjera të parashikuara në paketën fiskale, që bashkëshoqëron buxhetin që po diskutohet sot, është një masë shumë pozitive, që do të japë mundësinë që, në rastet e lejueshme, këto fonde të përdoren për zëra të tjerë në arritjen e objektivave për mbështetjen buxhetore të Bashkimit Europian edhe në zbatimin e kritereve për procesin e negociatave nga Shqipëria.

Avancimi për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, pavarësisht procesit tepër sfidues dhe kohëve që po jetojmë, vijon të mbetet një prioritet për qeverinë shqiptare dhe maxhorancën, e cila reflektohet qartazi në mënyrë shumë dimensionale edhe në buxhetin që po diskutohet sot.

Prandaj, kolegë të nderuar, duke u nisur nga fakti që agenda europiane na bashkon si opozitë dhe maxhorancë, ju ftoj ta miratoni buxhetin. Faleminderit!